



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

Oda e Infermierëve të Kosovës dhe profesionistët tjera shëndetësor të Kosovës Komisi i ndëshkimit vjetar, kufiz i vjetard i drejtiveve struktura Kosova Shërbime, dhunave, midwives, and other health professionals of Kosovo		
ARKIV ARHIV ARCHIVE		
Nr. Prot. 292 Brqj. prot. Prot. no.	Nr. i fag. 4 Br. str. No. page	Data: 19.04.19 Datum: Date:
PRISTINA PRISTINA - PRISTINA		

Oda e Infermierëve të Kosovës



Kryqi i Kuq i Kosovës
Red Cross of Kosova
Prishtinë

DRAFT MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Në mes të

Odës së Infermierëve të Kosovës

dhe

Kryqit të Kuq të Kosovës- KKK

për

Bashkëpunim në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional për profesionistët shëndetësor/infermierë, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të shërbimeve shëndetësore në fushën e Pakos Minimale Fillestare të Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS), Edukimit Shëndetësor të Familjes dhe Ndihma e Parë.

Kryqi i Kuq i Kosovës, është e vetmja Shoqatë Kombëtare në Republikën e Kosovës e cila zhvillon programe dhe veprimtari brenda kornizave të përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Kosovës, irregullave dhe irregulloreve të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Republika e Kosovës e njeh Kryqin e Kuq të Kosovës, Shoqatë Kombëtare autonome e cila punon për të mirën publike, si ndihmëse e autoriteteve vendore. Kryqi i Kuq i Kosovës respekton dhe udhëhiqet në veprimtarinë e vet nga Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq/Gjysmëhënës së Kuqe dhe të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.

Me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellët me Odën e Infermierëve të Kosovës - OIK për të siguruar edukim të vazhdueshëm profesional cilësor për profesionistë shëndetësorë/infermierë në bazë të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe zhvillimit të shkathtësive profesionale praktike;

Palët pajtohen si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i këtij Memorandumi

1.1 Ky Memorandum i Mirëkuptimit ka për qëllim të vendosë një bashkëpunim në mes të Odës së Infermierëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: OIK) dhe Shoqatës Kombëtare të Kryqit të Kuq të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: KKK), për zbatimin e aktivitetave në kuadër të Programeve dhe aktivitetave Shëndetësore të Kryqit të Kuq të Kosovës.

1.2 Përmes këtij memorandumi do të arrihet planifikimi dhe zbatimi i moduleve të trajnimeve në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional për profesionistë shëndetësor/infermierë, në kuadër të Pakos Minimale Fillestare të Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS), Edukimit Shëndetësor të Familjes dhe Ndihma e Parë.

1.3 Përmes këtyre aktivitetave synohet përmirësimi i qasjes në shërbime cilësore për ngritjen e cilësisë së aktivitetave për promovimin e shëndetit dhe ofrimit të ndihmës për institucionet shëndetësore në promovimin e aktivitetave që ndërlidhen me Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në raste të emergjencave, sëmundjet gjitëse, edukimin shëndetësor dhe ofrimin e ndihmës së parë. Aktivitetet tona shëndetësore kanë për qëllim avancimin e shëndetit të popullatës përmes aktivitetave që promovojnë shëndetin dhe përmes ofrimit të shërbimeve në komunitet, të gjitha në shërbim të qëllimit madhor-zvogëlimit të rasteve të vdekjeve e sëmundjeve si dhe rënies së ndikimit të sëmundjeve në emergjencat shëndetit publik.

Neni 2

Oda e Infermierëve të Kosovës

2.1 OIK do të inkorporojë në programin për zhvillim të vazhdueshëm profesional infermieri trajnimet dhe modulet e sipër përmendura në bazë të planit të miratuar të trajnimeve të Programeve për Pakon Minimale Fillestare të Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS), Edukimit Shëndetësor të Familjes dhe Ndihma e Parë.

2.2 OIK synon të bashkëpunoj me KKK në përmirësimin e standardeve të kujdesit dhe zbatimin e tyre ne shërbimet shëndetësore në nivel kombëtar.

2.3 OIK do të ofrojë mbështetje në organizimin dhe thirrjen e trajnimeve sipas mundësive dhe marrëveshjeve me KKK.

2.4 OIK do të akreditojë trajnimet nga planet e trajnimeve të Programeve Pakon Minimale Fillestare të Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS), Edukimit Shëndetësor të Familjes dhe Ndihma e Parë..

- 2.5 OIK në bashkëpunim me KKK do të bëjë mbikëqyrjen e trajnimeve të sipër përmendura.
- 2.6 OIK nga stafi i vetë do të delegojë pjesëmarrës në trajnimet e Pakos Minimale Fillestare të Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS).

Neni 3

Obligimet e KKK

- 3.1 KKK do të ofrojë përkrahje teknike dhe profesionale OIK-së për planifikimin dhe implementimin e moduleve të trajnimeve për profesionistët shëndetësor/infermierë në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në kuadër të planeve të trajnimit të Programeve për Pakon Minimale Fillestare të Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS), Edukimit Shëndetësor të Familjes dhe Ndihma e Parë.
- 3.2 KKK do të mbështesë dizajnin e moduleve dhe zbatimin e trajnimeve sipas planeve të miratuara duke përfshirë edhe shpenzimet për trajnime dhe shpenzimet logistike rrëth organizimit.
- 3.3 KKK synon që trajnimet dhe modulet të dizajnohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, për mbrojtjen e të dhënavë personale dhe mos-diskriminim.
- 3.6 KKK do të jetë në konsultim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me OIK përgjatë zbatimit të këtij memorandumi.

Neni 4

Zbatimi

- 4.1 Palët pajtohen se do të përkujdesën për zbatimin me përkushtim dhe përpikëri të kësaj marrëveshje.

Neni 5

Vlefshmëria kohore

- 5.1 Palët nënshkruese u pajtuan që vlefshmëria kohore e këtij memorandumi të mbetet në fuqi deri në momentin e përfundimit të Programeve Pakon Minimale Fillestare të Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHRS), Edukimit Shëndetësor të Familjes dhe Ndihma e Parë të përkrahur nga UNFPA, UNICEF dhe KKK.
- 5.2 Palët do të shqyrtojnë vazhdimësinë e bashkëpunimit edhe në periudhën e tranzicionit përtej mbështetjes nga donatorët.

5.3 Palët nënshkruese ruajnë të drejtën e tërheqjes nga kjo marrëveshje me paralajmërim paraprak me shkrim prej së paku 30 ditë.

Neni 6

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

5.1 Marrëveshja është nënshkruar në dy (2) kopje identike origjinale, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese dhe e njëjta hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

Për Odën e Infermierëve të Kosovës:

Naser Rrustemaj


Kryetar i OIK-ut



Nënshkruar me datë: 19.04.2017

Për KKK:

Ajram Humalli
SEKRETAR I PERGJITHSHËM



Në: President